V E N D I M
Nr.361, datë 5.6.2003

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KOMUNËS SË MAMINASIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi të Komunës së Maminasit, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi. Kjo listë paraprake, sipas kërkesave të këshillit të komunës së Maminasit, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të Komunës së Maminasit, miratuar me vendimin nr.103, datë 20.2.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Maminas".

2. Ngarkohet Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Komuna e Maminasit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fushat e përdorimit të pronës
1-12	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore
13-20	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik
28-30	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor
31-55	Varreza publike
56	Prona që përdoren për mbrojten civile
57-66 (vetëm rrjeti terciar)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (ujitje kullim)
82	Ujësjellsa të veçantë të fshatrave
83	Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza
85-86	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit
87-92	Rrugë vendore
93-95	Troje dhe hapësira publike
96	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik